



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE FINANCIARE  
DREJTORIA E DREJTIMIT TË BORXHIT PUBLIK

**Shpallja e propozimit fitues lidhur me përzgjedhjen e Lead Manager që do drejtojë procesin e emetimit të Eurobondit**

Nga datat 22 prill – 11 maj 2015 në Ministrinë e Financave u shqyrtuan propozimet e paraqitura nga bankat për emetimin nga Republika e Shqipërisë të Eurobondit në tregun ndërkombëtar.

Vlerësimi i propozimeve u bë mbi bazën e :

1. Eksperiencës së institucioneve në transaksione të ngjashme, prezencën e tyre në tregje dhe kapacitetin për sigurimin e financimit të kërkuar;
2. Risqeve të ndryshme që mbart secili prej propozimeve;
3. Kostos më të ulët efektive me të gjitha elementet e saj, si:
  - a) Afati i maturimit
  - b) Mënyra e shlyerjes
  - c) Komisionet, interesi dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në koston e huamarrjes në varësi të kushteve të tregut.

Në përfundim të vlerësimit, Ministria e Financave shpall fituese propozimet e paraqitura nga Deutsche Bank dhe JP Morgan Chase duke i përzgjedhur ato si Bashkë-udhëheqës kryesorë (Joint Lead Managers) për të drejtuar procesin e emetimit nga Republika e Shqipërisë të eurobondit.